



Në bazë të nenit 45 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-63130/19 19.03.2019, të pronarit Xhavit Morina nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shtëpi individuale, ndërtuar në kuadër të bllokut urban “L-20”, të tërsisë hapësinore “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në rr. “Bajo Topulli” nr. 35, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 01.04.2019, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Xhavit Morina nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-63130/19 19.03.2019, përdorimi i ndërtesës shtëpi individuale, me etazhitet B+1, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-239001 dt. 09.01.2015, në parcelën kadastrale nr. 1736-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 212-2, 242-3 dhe 242-4), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914075-1736-0 ZK Çagllavicë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “L-20”, të tërsisë hapësinore “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, të ndërtuara në rrugët “Bajo Topulli” nr. 35, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarit Xhavit Morina nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-63130/19 19.03.2019, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shtëpi individuale, me etazhitet B+1, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “L-20”, të tërsisë hapësinore “L”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1736-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 212-2, 242-3 dhe 242-4), ZK Çagllavicë, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-239001 dt. 09.01.2015, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 356-131307 dt. 20.12.2018, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final, 09 Nr. 356-131307 dt. 20.12.2018 të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës si dhe Inspektimin Final të dt. 20.12.2018, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1. Inspektimi i themelit me datë 28.05.2016;

Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes me datë 03.06.2016; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit me datë 06.06.2016; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut me datë 10.06.2016; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit me datë 14.07.2016; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik me datë 09.09.2016; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit me datë 10.06.2016; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Hesim Pacolli me nr. të licensës 01;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi individuale mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shtëpi individuale.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-63130/19 DT. 01.04.2019**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Lindita Beqiri

